



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA IV

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 27.

Prishtinë, më 13.01.2012 në ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Goran Marinkovic, Elmi Reçica, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, Mufera Sinik, Rasim Demiri.

Munguan: Glauk Konjufca, Jasmina Živkovic, Jelena Bontic, Petar Miletic dhe Etem Arifi.

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësues të OSB-ja Elita Vokshi, Sanije Berisha, përfaqësuesit nga KDI-Florije Mehmeti, përfaqësues nga ICO-ja Dejan Qosic, përfaqësuesi nga Ambasada Amerikane dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit: Natasa Prica-Tisma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Goran Marinkovic, kryetari i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara.
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-76 për Policinë, me raportin e Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me amendamente.
4. Miratimi i Raportit të punës së Komisionit për vitin 2011.
5. Hartimi i Draft- Planit të punës për vitin 2012.
6. Informatë për Përfundimin e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës nr. 04-P-065 lidhur me skadimin e mandatit të anëtarëve të bordeve, komisioneve dhe këshillave të organeve të pavarura.
7. Të ndryshme

Kryesuesi - konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Krzesuesi - konstatoi se rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

Kryesuesi – konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjeve të datës 15.12.2011 dhe 16.12.2011, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-76 për Policinë, me raportin e Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me amendamente.

Kryesuesi- Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin nr. 04/L-76 për Policinë, të propozuara nga Komisioni funksional.

Në fjalinë e tij veçoi, se si anëtarë në të njëjtin komision, lidhur me këtë projektligj Komisioni ka punuar me përpikëri dhe se nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Meqë nuk kishte vërejtje, Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I..Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për Policinë nr. 04/ L-76 dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisionit funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

4. Miratimi i Raportit të punës së Komisionit për vitin 2011.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim raportin e punës dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse ka ndonjë vërejtje apo plotësim.

Meqë nuk kishte vërejtje, Komisioni njëzëri miratoi raportin e punës për vitin 2011

5. Hartimi i Draft- Planit të punës për vitin 2012.

Kryesuesi, me theks të veçantë tha se komisioni ende nuk e ka strategjinë Legjislative të Qeverisë për periudhën 2012. Posa të arrihet programi legjislativ 2012, komisioni do të hartoj planin e punës duke i përcaktuar detyrat e saja në mbështetje të afateve kohore të legjislativit, në bazë të Raportit të progresit dhe i njëjti do të miratohet nga ky komision.

6. Informatë për Përfundimin e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës nr. 04-P-065 lidhur me skadimin e mandatit të anëtarëve të bordeve, komisioneve dhe këshillave të organeve të pavarura.

Komisioni shqyrtoi informatën lidhur me përfundimin e skadimit të mandatit të anëtarëve të bordeve, komisioneve dhe këshillave të organeve të pavarura dhe murr qëndrim se nga fuëshveprimtaria e saj dhe do ta zbatoj implementimin e tij.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Goran Marinkovic